



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.382/12 prot

Datë 18.03.2024

**V E N D I M**

**Nr. 286/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.03.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi klufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91674-12-19-2023 me objekt “*Loti 4 “Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore*” me fond limit 2 940 000 (Dy milione e nenteqind e dyzete mije) lekë pa TVSH ose 28 669 (Njzete e tete mije e gjashteqind e gjashtedhete e nente) EURO pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Vlorë, me adresë: “Lagja “Partizani”, Vlorë.

**Ankimues:**

“Biometric Albania” SHPK me NUIS J61827062E, me adresë: Blv “Zhan D’Ark”, P. Nr.53, Ap. 6B, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara:** "Aquarius Medical" SHPK, me NUIS L81512021D dhe adresë: "Rruga Don Bosko, Blloku Nr.1, Shkalla Nr.3, Kati I, Nr.4, Tiranë"

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.12.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit "Procedurë e hapur mbi klufirin e lartë monetar", me Nr. REF-91674-12-19-2023 me objekt "Loti 4 "Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore" me fond limit 2 940 000 (Dy milione e nenteqind e dyzete mije) lekë pa TVSH ose 28

669 (Njete e tete mije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e nente) EURO pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 05.02.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave si më poshtë vijon:

“Aquarius Medical” SHPK	2.040.000 lekë, kualifikuar
“Biometric Albania” SHPK	2.391.000 lekë, skualifikuar
“CFO Pharma” SHPK	2.490.000 lekë, kualifikuar
“ALMedical” SHPK	2.502.000 lekë, kualifikuar
“Trimed” SHPK	2.679.000 lekë, kualifikuar
“Florifarma” SHPK	2.751.000 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, është njoftuar për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

*“OE Biometric Albania shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik certifikatat Issso certifikatate konformiteti CE, si dhe autorizim prodhuesi ne gjuhe te huaj (anglisht ) dhe jo ne Gjuhen Shqipe. Mbeshtetur ne ligjin e prokurimit publik Neni 74” dokumentat e tenderit” pika 1 citohet ”Autoriteti ose enti kontraktor, ne hartimin e dokumentave te tenderit, perdor dokumenta standarte, sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike. Ne dokumentat standarte te kesaj procedure dhe pikerisht ne formularin e kriterëve te perzgjedhjes si dhe ne kriteret e vecanta te kualifikimit pikat 4,5,6, eshte cilesuar qe dokumentat duhen te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe dhe te noterizuar..”*

II.3. Në datën 09.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 16.02.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 382 prot., dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3809 e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi klufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91674-12-19-2023 me objekt “Loti 4: “ Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore” me fond limit 2 940 000 (Dy milione e nenteqind e dyzete mije) lekë pa TVSH ose 28 669 (Njete e tete mije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e nente) EURO pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Në datën 01.02.2024 jemi njohur në SPE me vlerësimin e kësaj procedure si më poshtë:

“Aquarius Medical” SHPK	2.040.000 lekë, skualifikuar
“Biometric Albania” SHPK	2.391.000 lekë, skualifikuar
“CFO Pharma” SHPK	2.490.000 lekë, kualifikuar

<i>“ALMedical” SHPK</i>	<i>2.502.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“Trimed” SHPK</i>	<i>2.679.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“Florifarma” SHPK</i>	<i>2.751.000 lekë, skualifikuar</i>

*Arsyeja e skualifikimit të ofertës së Biometric Albania është se dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën anglisht.*

*Në datën 05.02.2024 AK ka publikuar një tjetër vlerësim të kësaj procedure për të cilin jemi njohur në SPE si më poshtë:*

<i>“Aquarius Medical” SHPK</i>	<i>2.040.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“Biometric Albania” SHPK</i>	<i>2.391.000 lekë, skualifikuar</i>
<i>“CFO Pharma” SHPK</i>	<i>2.490.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“ALMedical” SHPK</i>	<i>2.502.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“Trimed” SHPK</i>	<i>2.679.000 lekë, kualifikuar</i>
<i>“Florifarma” SHPK</i>	<i>2.751.000 lekë, skualifikuar</i>

*Arsyeja e skualifikimit të ofertës së Biometric Albania është se dokumentacioni i paraqitur është në gjuhën anglisht.*

*Në datën 09.02.2024 sipas publikimit të njoftimit të APP, ka nisur afati i ankimit për procedurën e mësipërme.*

*Së pari vëmë në dukje se lloji i procedurës së prokurimit në fjalë është Open International (E hapur nderkombetare). Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhën shqip ose anglisht.*

*Gjithashtu vëmë në dukje se në versionin shqip të DST është markuar vetëm gjuha shqipe, ndërsa në versionin anglisht të DST janë markuar të dyja gjuhët, duke qenë se procedura është e hapur nderkombetare mbi kufitrin e lartë monetar.*

*Në datën 08.01.2024 në SPE kompania Montal SHPK ka kërkuar një sqarim në lidhje me këtë procedurë prokurimi, referuar gjuhës së përgatitjes së ofertave dhe dokumentave përkatëse që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomikë në këtë procedurë.*

*Në vijim të kësaj kërkesë, në datën 08.01.2024 autoriteti kontraktos ka kthyer përgjigje ku ka konfirmuar që në përputhje me LPP-në, ofertat mund të dorëzohen në gjuhën shqip ose anglisht.*

*Sa më sipër Biometric Albania SHPK ka paraqitur dokumentat e prodhuesve të produkteve objekt prokurimi në gjuhën anglisht në përputhje me DST dhe në përputhje me rregullat e prokurimit publik.*

*Së dyti; nisur nga përvoja jonë shumëvjeçare në treg, duke qenë se kompanitë që kanë furnizuar prej vitesh spitalet e Shqipërisë me materiale mjekimi spitalore objekt të kësaj procedure prokurimi, paraqesim dyshimin tonë të arsyeshëm dhe pretendimin tonë që produktet e ofruara nga kompania Aquarius Medical nuk plotësojnë kriteret, specifikimet dhe standardet e kërkuara në DST. Ngrehmë dyshimet tona që KVO nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe korrekt në kontrollin e dokumentacionit dhe mostrave që kjo kompani ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi si dhe përputhjen me kërkesat për kualifikim të DST.*

*Për këtë arsye, bazuar në LPP, rregullat e prokurimit publik dhe udhëzimet e APP-së, kërkojmë nga KSH dhe KPP që të kryhet verifikimi dhe kontrolli i detajuar i dokumentacionit të paraqitur nga kompania Aquarius Medical sic janë Autorizimet e prodhuesve, Certifikatat ISO 13485:2016 ose ISO 9001:2015 për prodhuesit, Certifikatat CE dhe Deklarata*

konformiteti, katalogët e paraqitur për produktet e ofruara dhe të bëhet krahasimi i tyre me mostrat e prezantuara në tender nga kjo kompani.

Lutemi që të bëhet verifikimi i përputhshmërisë së origjinës, kompanive prodhuese dhe kodeve të shënuara në etiketën e mostrave me origjinat dhe kompanitë prodhuese të prezantuar në formularin e ofertës (shtojca 1) si dhe ato të paraqitura në dokumentacionin përkatës të paraqitur nga OE Aquarius Medical, pra në certifikatat e konformitetit dhe në katalogët respektivë.

Që një ofertë të konsiderohet e rregullt dhe sipas kërkesave në DST, nevojitet që të gjithë elementët e mësipërm të jenë korrekte dhe në përputhshmëri me njëri tjetrin, cka do të thotë:

1. Kompanitë prodhuese dhe origjina mbi paketimin e cdo mostre (të cilat duhet të evidentohen qartë) duhet të jenë të njëjta me origjinën dhe prodhuesit e deklaruar në formularin e ofertës.
2. Të verifikohet që nga prodhuesi i evidentuar mbi paketimin e mostrës dhe në formularin e ofertës, është marrë Autorizim i rregullt drejtuar kompanisë Aquarius Medical për shitjen e produkteve objekt prokurimi në territorin e Shqipërisë.
3. Prodhuesi/t përkatës të evidentuar në katalogun e paraqitur të jenë të njëjtë me ata të paraqitur në ofertë, dokumentacion dhe paketimin e mostrave.
4. Specifikimet e markuara në katalog të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të artikujve të kërkuar në DST.
5. Certifikata CE të jenë të rregullta sipas Direktivave përkatëse dhe të vlefshme në datën e hapjes së tenderit ose në rast se kanë kaluar datën e skadencës, të jenë të shoqëruara me Dokument Konfirmimi nga Organi Certifikues për zgjatje të vlefshërisë sipas Rregullores (EU) 2023/607 të Këshillit Europian.

Sjellim në vëmendje që për disa nga artikujt, referuar kategorisë si materiale mjekësor, është e detyrueshme pajisja me certifikatë CE (për produkte e klasës II dhe klasës I sterile ose me funksion matës) dhe jo pajisja me vetëm deklarata të konformitetit (e aplikueshme vetëm për produktet e klasës I josterile). Rrjedhimisht për artikullin “Doreza kirurgjikale sterile (ndarë sipas numrit)”, i cili kategorizohet si pajisje mjekësore e Klasës II a, është e detyrueshme pajisja me Certifikatë CE, lëshuar nga një organ certifikues. Lutemi të verifikohet nëse operatori ekonomik në fjalë e ka paraqitur këtë certifikatë nga prodhuesi përkatës.

Sa më sipër, kërkojmë nga KSHA dhe më tej nga KPP [...] të bëhet verifikimi i detajuar i procesverbaleve të mbajtura nga ana e KVO-së, verifikimi i listës së mostrave të paraqitura nga Aquarius Medical nëse ato janë në përputhje me dokumentacionin e përmendur në argumentimin më lart, verifikimi i specifikimeve teknike të markuara në katalog me ato të kerkuara në DST si dhe verifikimi i dokumentave të faktit, ligjore dhe teknike të paraqitura nga Aquarius Medical në këtë procedurë prokurimi. [...].”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 382/2, datë 19.02.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 382 prot., datë 16.02.2024 si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik

“Biometric Albania” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK.

II.6. Në datën 22.02.2024, është protokolluar në KPP me nr. 382/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor 790 prot., datë 19.02.2024.2024, me objekt: “ *Informacion mbi procedurën e prokurimit [...]*”, drejtuar Komsionit të Prokurimit Publik, bashkëngjitur shkresa me nr. 787 prot., datë 19.02.2024 me objekt: “Mbi vendimin për shqyrtim ankese Biometric Albania SHPK”, drejtuar KPP-së; shkresa nr. 786 prot., datë 19.02.2024 me objekt: “Vendim për shqyrtim ankese”, drejtuar Biometric Albania SHPK dhe për dijeni KPP-së, si dhe dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit. Me anë të vendimeve të sipërcituara, informohet Komisioni i Prokurimit Publik mbi refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK. Shprehimisht autoriteti kontraktor ka arsyetuar si më poshtë vijon:

*“[...] Me datë 01.02.2024 nga ana e SPE janë njoftuar operatorët mbi kualifikimet/skualifikimet përkatëse të kësaj procedure ku operatori ekonomik ankimues është i skualifikuar për arsye se ka paraqitur në SPE certifikatat ISO dhe certifikatë konformiteti CE si dhe autorizim prodhuesi në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) dhe jo në gjuhën shqipe.*

*Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik Kriteret e vecanta*

*Ofertuesi duhet të paraqese Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar) ose MDR, për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të perkthyer dhe të noterizuar. **Per secilin lot***

*Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë, ku ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejitimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe të noterizuar) **Per secilin lot.***

*OE ka të drejtë të ankimojë kriteret e përcaktuara nga AK në zbatim të LPP-së, por operatori ekonomik nuk i ka ankimuar duke arritur në konkluzion se operatori ekonomik i pranon këto kritere dhe stricto jure duhet tu përmbahet në mënyrë që oferta e tyre të jetë e suksesshme. [...]*

*Për sa i përket pretendimit të OE në lidhje me gjuhën me të cilën duhet të dorëzohet oferta, neni 24/2 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, përcakton se:*

*Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentat e tenderit duhet të hartohen në gjuhën shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhën shqip ose anglisht.*

*Në DST “Blerje materiale mjekimi për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, ndarë në lote [...], në pikën 4.7 (faqe 12)*

#### **4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip**

**x**

**Anglisht**

Bazuar në argumentat e sipërcituar ju ritheksojmë se operatorët ekonomikë duhet ti përmbaheshin DST-ve dhe duke qënë se në gjuhën e procedurës së prokurimit është markuar vetëm gjuha shqipe oferta dhe dokumentacioni i prodhuesve që duhet të dorëzonin OE në këtë procedurë duhet të ishin të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

Oferta e paraqitur nga ana juaj për këtë procedurë prokurimi ka qënë e përzier në gjuhën shqip dhe anglisht, gjë që është në kundërshtim të plotë me DST dhe nenin 24/2 të VKM-së 285 datë 19.05.2021.

Në lidhje me pikën 2 të ankesës:

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimes Biometric Albania SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Aquarius Medical SHPK, duke e cilësuar atë si jo të rregullt dhe në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, LPP dhe RRPP.

KSHA, pasi shqyrtoi në themel ankesën e operatorit ekonomik ankimes mbi shkaqet e skualifikimit të ofertës së tij, konstaton se për pjesën tjetër të ankimit nuk legjitimohet pasi nuk gëzon asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi.

Në nenin 94 pika 1 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Pra në këtë dispozitë kushtet për të paraqitur ankesë janë kumulative dhe duhet të përmbushen të dyja së bashku. Interesi në procedurën e prokurimit nga ana e ankimesit ekziston por kushti i dytë: kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, nuk ekziston pasi AK me vendimin e tij nuk dëmtojnë dhe as rrezikojnë cilësinë/pozitën dhe interesat e ankimesit në këtë procedurë prokurimi.

Mbi interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, në kuptim të ligjit aktual të në fuqi, ashtu edhe etë së drejtës së tyre për të ushtruar të drejtën e ankimit për skualifikimin e ofertës së tyre nga veprimet e autoritetit kontraktor dhe për kualifikimin e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt ankimi arhumentojmë gjithashtu se cdo person që pretendon se ka interes në një procedurë prokurimi, se është dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, duhet ti referohet një situatë konkrete për të provuar cënimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, interes i cili individualizohet nga elementë konkretë si subjektet (palët) dhe shkaku (e drejta ose marrëdhënia juridike e cënuar që ndodhet në themel të ankesës). Operatori ekonomik ankimes që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo intere i ligjshëm, apo që rrezikon të cënohet, duhet të identifikojë faktin që përbën cënimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para dorëzimit të ankesës.

Pavarësisht legjitimit të ankimesit për të pretenduar mbi operatorët e tjerë pjesëmarrës në prokurim, KSHA me qëllim që të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurën e prokurimit, gjykon të arsyeshme të verifikojë pretendimin mbi kualifikimin e OE Aquarius Medical SHPK.

Anëtarët e KSHA-së pasi u loguan me kredencialet e tyre në SPE për të verifikuar pretendimet e Biometric Albania SHPK verifikuan si më poshtë vijon:

Në DST nga njësia e prokurimit , në pikën 2.3 Kapaciteti teknik Kriteret e vecanta të kualifikimit, është kërkuar:

**Per secilin lot**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimin te cilesise ", /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar) ose MDR, per te gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, te perkthyer dhe te noterizuar. **Per secilin lot**

Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi per territorin e Shqiperise, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të përkthyer dhe te noterizuar) **Per secilin lot**

**Loti 4 : “ Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore”**

Nr	Artikulli	Specifikime
1	Doreza egzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.
2	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5

Nga verifikimet e dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik Aquarius Medical SHPK, është i plotë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara.

Ky operator ekonomik fillimisht në datën 29.01.2024 i është kërkuar sqarim mbi ofertën ekonomike nga KVO dhe në datë 31.01.2024 operatori ekonomik është përgjigjur në SPE në kategorinë “Kërkesë” por KVO, duke qënë se nuk i është shfaqur përgjigja e operatorit ekonomik, ka vijuar me vlerësimin e procedurës, duke skualifikuar me datë 01.02.2024 operatorin ekonomik Aquarius Medical SHPK, në zbatim të nenit 93 të LPP-së.

Me datë 05.02.2024 pas këtij vlerësimi është shfaqur në kategorinë kërkesë përgjigja nga operatori ekonomik Aquarius Medical SHPK së bashku me argumentimin përkatës, të cilat, pasi u shqyrtuan nga KVO, kryen rivlerësimin në SPE me datë 05.02.2024, duke kualifikuar operatorin ekonomik Aquarius Medical SHPK. Nga ky rivlerësim i procedurës, u gjykua dhe



*vlerësua operatori ekonomik Aquarius Medical SHPK, ndërsa ankimesit nuk i ndryshoi statusi i mëparshëm.*

*Ky pretendim nuk pranohet.”*

II.7. Në datën 27.02.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 382/4 prot., *“Formulari i paraqitjes së argumenteve”*, nga operatori ekonomik i interesuar *“Aquarius Medical” SHPK*, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, *“Për Prokurimin Publik”*.

II.8. Në datën 01.03.2024, nëpërmjet shkresës me nr.382/5 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave pranë KPP-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK”*, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë pranë këtij Komisioni, mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik *“Aquarius Medical” SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 05.03.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 382/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Spitali Rajonal Vlorë me nr. 1051 prot., datë 05.03.2024, me të së cilës njoftohet Komisioni i Prokurimit Publik për paraqitjen e mostrave të shoqërisë *“Aquarius Medical” SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Autoriteti kontraktor ka dorëzuar në KPP, mostrat e paraqitura nga shoqëria *“Aquarius Medical” SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Duke qënë se nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vendimi i KSHA-së lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, si dhe mostrat e paraqitura në tender nga shoqëria *“Aquarius Medical” SHPK*, por mungon procesverbali i KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave sipas Udhëzimit nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik *“Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”*, në datën 08.03.2024, nëpërmjet shkresës me nr.382/7 prot., me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave pranë KPP-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK”*, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar me procesverbalin e KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave të operatorit ekonomik *“Aquarius Medical” SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Në datën 12.03.2024 është protokolluar në KPP me nr 382/8 prot., shkresa e autoritetit kontraktor, mbërritur nëpërmjet postës elektronike të KPP-së, me nr.1165 prot., datë 11.03.2024, me objekt: *“Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekimi për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, ndarë në lote, gjithsej 4 (katër) Marrëvshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ) një OE të vetëm fitues për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 1 vjeçar (12 muaj), fondi limit 49.017.759 lekë pa TVSH “Blerje doreza ekzaminimi dhe kirurgjikale për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, Loti 4 me REF-91674-12-19-2023”*, bashkëngjitur procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave të shoqërisë *“Aquarius Medical” SHPK* datë 19.01.2024, firmosur nga KVO-ja dhe përfaqësuesi i subjektit në fjalë, si dhe lista e mostrave të dorëzuara nga shoqëria *“Aquarius Medical” SHPK*.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit, dokumentacionit dhe mostrat e paraqitura nga ana e autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK, me arsyen se: **“OE Biometric Albania shpk ka paraqitur ne sistemin elektronik *certifikatat Issso certifikatate konformiteti CE, si dhe autorizim prodhuesi ne gjuhe te huaj (anglisht ) dhe jo ne Gjuhen Shqipe*. Mbeshtetur ne ligjin e prokurimit publik Neni 74” dokumentat e tenderit” pika 1 citohet “Autoriteti ose enti kontraktor, ne hartimin e dokumentave te tenderit, perdor dokumenta standarte, sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike. Ne dokumentat standarte te kesaj procedure dhe pikerisht ne formularin e kriterëve te perzgjedhjes si dhe ne kriteret e vecanta te kualifikimit pikat 4,5,6, eshte cilesuar qe dokumentat duhen te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe dhe te noterizuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:**

III.1.1. Në datën 20.12.2023, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi klufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91674-12-19-2023 me objekt “Loti 4“Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore” me fond limit 2 940 000 (Dy milione e nenteqind e dyzete mije) lekë pa TVSH ose 28 669 (Njzete e tete mije e gjashteqind e gjashtedhete e nente) EURO pa TVSH. Dokumentat e tenderit janë publikuar në gjuhën shqip dhe anglisht.

III.1.2. Në datë 19.01.2024 autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Vlorë ka zhvilluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.3. Në Shtojcës 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti teknik, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar, përveç të tjerave, si më poshtë vijon:

*3. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

#### **Per secilin lot**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimin te cilesise ”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

#### **Per secilin lot**

*5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ,Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, te perkthyer dhe te noterizuar. **Per secilin lot***

6. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë, ku në çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe të noterizuar) **Per secilin lot**

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 24 pika 2 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”

III.1.7. Në dokumentet e tenderit “Njoftimi i kontratës”, seksioni 4 “Procedura”, pika 4.7, i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

#### **4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip**

**x**

**Anglisht**

---

Ndërsa në dokumentat e tenderit të publikuara në gjuhën angleze, në pikën 4.6 të “Njoftimi i kontratës”, është parashikuar si vijon:

**4.6 Language(s) in which bids may be drawn up:**

**Albanian** + **English** +

III.1.8. Në rastin konkret, lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për ofertën e paraqitur nga ankimuesi “Biometric Albania” SHPK, duke qenë se procedura objekt ankimi është një procedurë prokurimi e hapur mbi kufirin e lartë monetar, i jep të drejtë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dokumentet e tyre në të dyja gjuhët. Pra fakti që Certifikatat ISO, Certifikatat e Konformiteti CE, si dhe Autorizim Prodhuesi janë në gjuhën angleze, nuk duhet të përbëjë arsye skualifikimi, pasi kjo gjuhë është njëra nga gjuhët e ofertës, kërkesë e cila është parashikuar edhe në seksionin 4, pika 4.6 të “Njoftimi i kontratës” në dokumentat e tenderit në gjuhën angleze, si më sipër cituar si dhe në kushtet kur procedura e prokurimit është prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dhe dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët; shqip dhe anglisht, gjë e cila është respektuar nga ana e autoritetit kontraktor duke i hartuar DT-të në dy gjuhë dhe njëkohësisht operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht, në përputhje edhe me nenin 24 pika 2 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si më sipër cituar.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues përse i përket mostrave të paraqitura nga shoqëria “Aquarius Medical” SHPK dhe mënyrës së administrimit të tyre nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2, 6, 8 dhe 9 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve të DST.*
6. *Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi per territorin e Shqipërisë, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe te noterizuar) **Per secilin lot***
8. *Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit te artikullit ne Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe te markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al)*

së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht) **Per secilin lot**

9. Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar.

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Autoriteti Kontraktor, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para datës 19.01.2024, ora 10 :00\_.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

**Per secilin lot**

III.2.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, është parashikuar si vijon:

Loti 4 : “ Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore ”

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia	Sasa e Planifikuar	Destinacioni	Periudha e dorezimit
1	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral, me puder , me permasa XS, S, M, L.	Cope	300,000	Spitali Rajonal Vlore	Brenda afatit te MK, sipas nevojave te AK
2	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	Pale	60,000	Spitali Rajonal Vlore	Brenda afatit te MK ,sipas nevojave te AK

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.2.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët

*ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.2.5. Në nenin 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.2.6. Në Udhëzimin nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, APP udhëzon si vijon:



1. Autoriteti//Enti kontraktor, mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentmit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim "SPE).

2. Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.

3. Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe në orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t'i vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

4. Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Mostrat e administruara do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur, procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. [...].”

III.2.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe

ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.8. Lidhur me pretendimet e ankimuesit përse i përket mostrave të paraqitura nga shoqëria “Aquarius Medical” SHPK, konstatohet se në formularin e ofertës nga ana e këtij të fundit është deklaruar se:

- Për artikullin me nr.rendor 1, “Doreza ekzaminimi (ndarë sipas numrit), josterile, me latex natyral, me pudër, me përmasa XS, S, M dhe L, kompania prodhuese është kompania “Bergamot” me origjinë në Malajzi.
- Për artikullin me nr.rendor 2 “Doreza kirurgjikale sterile (ndarë sipas numrit) me pudër, latex natyral, pakeluar në zarfe letre të sterilizuara me rreze Gamma ose gaz Etilen sipas normativave EN, madhësia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5, kompania prodhuese është deklaruar kompania “Tianchang City Anrui Medical Equipments Co.Ltd/Shangai Kinmed, me origjinë në Kinë.

Ndërsa në ofertën e shoqërisë “Aquarius Medical” SHPK, rezulton se për artikullin me nr.rendor 1, është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Autorizim i prodhuesit “Bergamot” Malajzi, datë 28.prill 2022, me anë të së cilës “Bergamot Sdn, prodhues zyrtar i dorezave Latex dhe Nitrile me banim në [...] Malajzi, deklaroi se: *““Golda” SHPK është Distributori ynë ekskluziv, prandaj është i autroizuar të prezantojë kompaninë dhe produktet tona, të tregtojë, të shpërndajë, të bëjë ofertë komerciale dhe teknike, të paraqesë oferta brenda territorit të Shqipërisë. Kjo marrëveshje është e vlefshme dhe efektive për dy vjet nga data e kësaj letre. Pas skadimit të kësaj letre, kjo Letër Marrëveshje do të zgjatet edhe për dy (2) vjet të tjerë, me kusht që palët të kenë marrëveshje reciproke me shkrim.”*
2. Autorizim distributori, lëshuar me datë 28.04.2022 nga kompania “Golda” SHPK, me anë të së cilës, kjo kompani autorizon “Aquarius Medical” SHPK të prezantojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë kompaninë prodhuese/distributor dhe produktet tona, të tregtojë, të shpërndajë, të bëjë oferta komerciale dhe teknike për produktet: Doreza jo sterile (një përdorimshe) Latex me pudër, pa pudër, nitril. Të paraqesë oferta ekonomike në procedurat e prokurimit publik të organizuara nga të gjithë institucionet shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë dhe për rrjedhojë

të nënshkruajë kontaktin furnizimi. Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë 2 (dy) vjetecare.

3. Katalog i kompanisë “Bergamot” për artikullin “Doreza Latex” me treguesit teknike me latex natyral, me puder , me permasa XS, S, M, L.

Për artikullin me nr.rendor 2, është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Marrëveshje e Agjencisë me datë 03. Janar 2022, me anë të së cilës kompania “Tianchang City Anrui Medical Equipments Co.Ltd, prodhues i dorezave kirurgjikale Latex në [...] Provinca Anhui, Kinë, deklaroi se: *“Shanghai Kinmed Import & Export Co.Ltd është agjenti ynë eksporti në të gjithë vendet, për të gjithë produktet. Vlefshmëria e autorizimit është 5 vjet.”*
2. Letër autorizimi, lëshuar me datë 16 korrik 2022 nga kompania “Shanghai Kinmed Import & Export Co.Ltd”, me anë të së cilës, kjo kompani konfirmon se *“Aquarius Medical” SHPK është shoqëria e autorizuar për importin dhe shpërndarjen e produkteve tona: Artikuj mjekësorë të disponueshëm, veshje kirurgjikale, materiale harxhuese mjekësore, pajisje mjekësore etj, për të gjitha produktet e kompanisë sonë në Shqipëri. Kjo marrëveshje është e vlefshme për 5 vjet dhe e rinovueshme për 5 vite të tjera, përveç nëse Aquarius Medical SHPK dërgon të paktën gjashtë muaj më parë njoftim me shkrim për qëllimin e tij për të anuluar këtë marrëveshje.”*
3. Katalog i kompanisë “Shanghai Kinmed Import & Export Co.Ltd” për artikullin “Doreza Kirurgjikale Latex” me materiale latex natyral, me permasat 6.0, 6.5, 7.0, 7.5, 8.0, 8.5.

III.2.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar që nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Autoritetit Kontraktor, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para datës 19.01.2024, ora 10:00. Gjithashtu është kërkuar që, së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2). Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2). Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në KPP nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është mbajtur një procesverbal më datë 19.01.2024 mbi dorëzimin e mostrave nga ofertuesi “Aquarius Medical” SHPK, për artikujt: 1. Doreza ekzaminimi (ndarë sipas numrit) me specifikime: *“Josteric , me latex*

*natyral, me puder , me permasa XS, S, M, L” dhe 2.Doreza kirurgjikale sterile (ndarë sipas numrit) me specifikime: “Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5”. Ky proces verbal rezulton i firmosur nga të dyja palët, si nga ana e KVO-së së autoritetit kontraktor ashtu edhe nga subjekti ofertues dhe është shoqëruar me listën e mostrave të dorëzuara për të dy artikujt nga shoqëria “Aquarius Medical” SHPK, të vulosur dhe firmosur nga kjo shoqëri.*

Nga shqyrtimi i mostrave të shoqërisë “Aquarius Medical” SHPK, të paraqitura në KPP nga autoriteti kontraktor, rezulton se mostrat janë futur në kuti jo transparente të vulosur nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK dhe mbi të cilin është bërë shënimi: *“Mos e hapni para datës 19.01.2024, ora 10:00, përvec Komsionit të Vlerësimit të Ofertave”*. Gjithashtu ofertuesi në fjalë ka paraqitur një shkresë me objekt: *“Lista e mostrave të dorëzuara”*, të vulosur dhe firmosur ku listohen mostrat që ndodhen në kuti. Në paketimin e mostrave “doreza kirurgjikale sterile” dhe “Doreza ekzaminimi” evidentohet qartë origjina e mallit që të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës.

Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi-, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Pas verifikimit të mostrave të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor, K.P.P. konstaton se artikujt “doreza kirurgjikale sterile” dhe “doreza ekzaminimi” të dorëzuar në cilësinë e mostrës nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK janë në përputhje me specifikimet teknike, dhe përmbajnë të gjitha të dhënat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Gjithashtu rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është *dokumentuar procesi i administrimit të mostrave, duke mbajtur procesverbalin përkatës i cili rezulton të jetë i nënshkruar nga të dyja palët, nga KVO-ja dhe përfaqësuesi ofertuesit objket ankimimi. Ky procesverbal është shoqëruar edhe me listaën e mostrave të paraqitura nga Aquarius Medical, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor si më sipër cituar.*

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: *“për artikullin “Doreza kirurgjikale sterile (ndarë sipas numrit)”, i cili kategorizohet si pajisje mjekësore e Klasës Ila, është e detyrueshme pajisja me Certifikatë CE, lëshuar nga një organ certifikues”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në shtojcën për modifikim, e publikuar në SPE në datën 26.12.2023, nga ana e autoritetit kontraktor është bërë modifikimi i dokumentatvetë tenderit, si vijon:

### **SHTOJCE PER MODIFIKIM**

***Dt. 26/12/2023***

***Per modifikim dokumentacioni tenderi me objekt:***

**Objekti: “Blerje materiale mjekimi për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” ndarë në lote, gjithsej 4 (kater) Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)**

**FONDI LIMIT : 49 017 759 ( Dyzete e nente milione e shtatembedhete mire e shtateqind e pesedhete e nente mije) Lek pa TVSH**

Autoriteti Kontraktor **SPITALI RAJONAL VLORE** do te shpalle tenderin me mjete elektronike ne adresen [ëëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al) sipas objektit te siperpermendur:

Në bazë të nenit 75, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të dispozitave të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **në zbatim të rekomandimeve te APP te dates 22.12.2023** ,

Njësia e Prokurimit vendos të bëjë modifikimet mbi kriteret e vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit.

## **ISHTE**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.**

### **Për secilin lot**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.” Si dhe ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 40 pika 5 a) Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

## **BEHET**

### **2.3 Kapaciteti teknik**

**2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE, Certificate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.**

#### **Për secilin lot**

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.*

## **ISHTE**

### **Shtojca 5**

#### **Specifikimete teknike te pergjithshme**

*Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.*

*Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.*

*Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.*

*Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.*

*Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi*

## **BEHET**

### **Shtojca 5**

#### **Specifikimete teknike te pergjithshme**

*Materialet e mjekimit duhet të permbushin standartet CE .*

*Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.*

*Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.*

*Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.*

*Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi*

III.3.2. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK rezulton se, për artikullin nr.2 është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Certifikatë KE, Sistemi i Sigurimit të Cilësisë së Prodhimit, Direktiva 93/42/EEC për Pajisjet Mjekësore (MMD) Aneksi V (Pajisjet në klasën IIa, IIb ose III) . Prodhuesi Tianchang City Arui, Medical Equipments Co., Ltd [...] RP e Kinës, për kategorinë e produktit (eve): Doreza kirurgjikale Latex. Sipas kësaj certifikate: *“Trupi certifikues i TUV SOD Product Service GmbH deklaron se prodhuesi i lartpërmendur ka zbatuar një sistem të sigurimit të cilësisë për prodhimin dhe inspektimin përfundimtar të pajisjeve/kategorive të pajisjeve përkatëse në përputhje me amdd Aneksin V. Ky sistem i sigurimit të cilësisë është në përputhje me kërkesat e kësaj direktive dhe i nënshtrohet mbikqyrjes periodike. Për tregtimin e pajisjeve të klasit IIb dhe III është e deyrueshme një certifikatë shtesë e Aneksit III. Shihni gjithashtu shënimet në pjesën e sipërme.”* Kjo certifikatë rezulton e vlefshme nga data 26.11.2019 deri më 26.05.2024.

III.3.3. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Ndërsa në nenin 79 të ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.3.5. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.3.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për



përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik "Aquarius Medical" SHPK, në përmbushje të këtij kriteri, ka dorëzuar Certifikatë KE, Sistemi i Sigurimit të Cilësisë së Prodhimit, Direktiva 93/42/EEC për Pajisjet Mjekësore (MMD) Aneksi V (Pajisjet në klasën IIa, IIb ose III) për prodhuesin Tianchang City Arui, Medical Equipments Co., Ltd [...] RP e Kinës, për kategorinë e produktit (eve): Doreza kirurgjikale Latex, lëshuar në datë 26.11.2019 nga trupi certifikues i TUV SOD Product Service GmbH, me anë të së cilës konfirmohet fakti se prodhuesi Tianchang City Arui, Medical Equipments Co., Ltd ka zbatuar një sistem të sigurimit të cilësisë për prodhimin dhe inspektimin përfundimtar të pajisjeve/kategorive të pajisjeve përkatëse në përputhje me MDD Aneksin V. Ky sistem i sigurimit të cilësisë është në përputhje me kërkesat e kësaj direktive dhe i nënshtrohet mbikqyrjes periodike. Certifikata rezulton e vlefshme deri më datë 26.05.2024.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik "Aquarius Medical" SHPK ka paraqitur certifikatën CE për kategorinë e produktit "Doreza Kirurgjikale Latex" në përputhje me kërkesat e parashikuara nga autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit si më sipër cituar, pasi vërtetohet se kjo certifikatë është lëshuar nga trupa certifikuese TUV SOD për kompaninë prodhuese Tianchang City Arui, Medical Equipments Co., Ltd, prodhimet e

të cilës, shoqëria objekt ankimimi ka ofertuar në procedurën e mësipërme të prokurimit për artikullin nr.2.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për Certifikatat ISO të shoqërisë “Aquarius Medical” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e tyre nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

*Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij lidhur me këto certifikata. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi klufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91674-12-19-2023 me objekt “Loti 4 “Blerje doreza egzaminimi dhe kirurgjikale per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore” me fond limit 2 940 000 (Dy milione e nenteqind e dyzete mije) lekë pa TVSH ose 28 669 (Njezete e tete mije e gjashteqind e gjashtedhete e nente) EURO pa TVSH, zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

